



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 22.05.2015, në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Luljeta Veselaj- Gutaj, Slobodan Petroviq dhe Kujtim Paçaku.

Munguan : Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Arben Gashi dhe Vjosa Osmani.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve.

Kryetarja hapi mbledhjen dhe tha se po vazhdojmë aty ku kemi mbetur, pra me shqyrtimin e amendamenteve të grupit punues, të cilat dje për mungesë kuorumi, nuk u përfunduan, dhe lidhur me këtë, ia dha fjalën kryesuesit të grupit punues.

Ilir Deda, tha se kemi mbetur te **amendamenti 15**. Grupi punues ka vendosur që në nenin 33, fjala **“i raportin”** të zëvendësohet me fjalët **“është në vartësi të”**. Rreth këtij amendamenti, kishte paqartësi dhe propozuan të hiqet. Komisioni nuk e miratoi amendamentin 15.

Amendamentet 16 dhe 17 u miratuan.

Ilir Deda, në vazhdim, propozoi që në nenin 29.3 që ka të bëjë me shkatërrimin e të dhënave që afati prej 12 muajve të zvogëlohet. Komisioni vendosi që **“12 muaj”** të zëvendësohet me **“9 muaj”**.

Po ashtu, edhe në nenin 30.2, nenin 30.3, në nenin 31.2 dhe 32.2, afati prej 12 muajve, zëvendësohet me 9 muaj.

Komisioni, pas diskutimeve dhe sqarimeve, miratoi këto propozime për amendamente.

Në nenin 32, paragrafi 2 fjalët **“dhe Prokurorit të Shtetit”**, u zëvendësuan me fjalinë, **“Prokurorit të Shtetit dhe komisioneve përkatëse parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës”**.

Në nenin 34, pas paragrafit 11, u propozua të shtohet paragraf i ri, si vijon:

12. “Konkluzionet e Komisionarit nuk ndikojnë në procedurën e ankesës individuale pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP)”.

Në Nenin 35, në fund të nenit, pas fjalës **“Komisionarit”**, u propozua të shtohet teksti **“më së largu 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”**.

Neni 36, paragrafi 3, u riformulua si vijon:

3. Të dhënat lidhur me thirrjet e trafikut që janë mbledhur dhe janë ruajtur në përputhje me ligjin, sipas urdhrat gjyqësor, nga një operator rrjeti ose ofruesi i shërbimeve, duhet të vazhdojnë të ruhen nga operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve për një periudhë 9 (nëntë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve duhet t'i vënë në dispozicion të dhënat e mbledhura dhe të ruajtura sipas paragrafit 3 të këtij neni për një periudhë prej 9 (nëntë) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kryetarja, pas diskutimeve, konstatoi se amendamentet e grupit punues, të cilat u miratuan dhe amendamentet e reja që u propozuan tani, kanë këtë radhitje:

Amendamenti 1

Në titullin e Projektligjit, fjalët **”Përgjimin e Telekomunikimeve”**, riformulohet si vijon:

“Përgjimin e Komunikimeve Elektronike”, ky riformulim vlen në tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 4, të fshihet.

Amendamenti 3

Neni 3, nën-paragrafi 1.9, në rreshtin e dytë, fshihen fjalët **“e Policisë së Kosovës”**.

Amendamenti 4

Neni 3, pas nënparagrafit 1.9, shtohet nënparagraf i ri, si vijon:

“1.10. Minimizim sipas urdhrat gjyqësor” nënkupton procesin teknik sipas të cilit zyrtari i autorizuar sipas urdhrat gjyqësor filtron të dhënat e marra gjatë përgjimit që nuk janë objekt i hetimit”.

Në vijim, bëhet rirenditja e nënparagrafëve.

Amendamenti 5

Neni 5, nënparagrafi 1.2, riformulohet si vijon:

“Përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës” dhe ky riformulim vlen në tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti i deputetit **Nait Hasani (pa përkrahjen e Komisionit)**:

Neni 5, nënparagrafi 1.2, riformulohet si vijon: **“Përgjimi për nevojat e sigurisë kombëtare”**.

Amendamenti i deputetit **Bekim Haxhiu (pa përkrahjen e Komisionit)**:

Neni 5, nënparagrafi 1.2, riformulohet si vijon: **“Përgjimi nga strukturat e inteligjencës për nevojat e sigurisë kombëtare”**.

Amendamenti 6

Neni 8, paragrafi 2, emërtimi **“Inspektorati Policor”**, zëvendësohet me emërtimin **“Inspektorati Policor i Kosovës”**.

Amendamenti 7

Neni 10, paragrafi 2, fjalët **“mund të jetë edhe”**, zëvendësohet me fjalën **“është”**.

Amendamenti 8

Neni 11, pas paragrafit 3, shtohet paragraf i ri, si vijon:

4. “Gjatë zbatimit të urdhrit për përgjim, zyrtari i autorizuar me urdhër gjyqësor është i obliguar për minimizimin e përgjimit sipas urdhrit gjyqësor”.

Amendamenti 9

Neni 13, pas paragrafit 5, shtohet një paragraf i ri, si vijon:

6. ” Subjekti i përgjimit, pas përfundimit të masës së ndërmarre, njoftohet në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale”.

Amendamenti 10

Teksti **“Kapitulli IV- Sistemi i Përgjimit”**, fshihet, kurse nenet në vijim, mbesin si në projektligj.

Amendamenti 11

Neni 16, fjala **“Njësitë”**, zëvendësohet me fjalën **“Njësia”**.

Amendamenti 12

Neni 18, nënparagrafi 3.2, fshihet, kurse nënparagrafi 3.3, bëhet 3.2.

Amendamenti 13

Neni 28, paragrafi 3, fjalët “**dymbëdhjetë muaj**” zëvendësohet me fjalët “**9 (nëntë) muaj**” .

Amendamenti 14

Neni 29, paragrafi 2, fjalët “**Policisë së Kosovës**” , zëvendësohen me fjalët “**Agjencisë Kosovare të Inteligjencës**”.

Amendamenti 15

Neni 29, paragrafi 3, fjalët “**dymbëdhjetë muaj**” zëvendësohen me fjalët “**9 (nëntë) muaj**”

Amendamenti 16

Neni 30, paragrafi 2, në tekstin e këtij paragrafi, fjalët “**dymbëdhjetë muajve**”, zëvendësohen me fjalët “**9 (nëntë) muajve**”.

Amendamenti 17

Neni 30, paragrafi 3, fjala “**dymbëdhjetë muajve**” zëvendësohet me fjalët “**9 (nëntë) muajve**”.

Amendamenti 18

Neni 31, paragrafi 2, fjalët “**12 (dymbëdhjetë) muaj**” , zëvendësohen me fjalët “**9 (nëntë) muaj**” .

Amendamenti 19

Neni 32, paragrafi 2 fjalët “**dhe Prokurorit të Shtetit**”, zëvendësohet me fjalinë: “**Prokurorit të Shtetit dhe komisioneve përkatëse parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës**”.

Amendamenti 20

Neni 34, pas paragrafit 11, shtohet paragraf i ri, si vijon:

12. “Konkluzionet e Komisionarit nuk ndikojnë në procedurën e ankesës individuale pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP)”.

Amendamenti 21

Neni 35, në fund të nenit, pas fjalës “**Komisionarit**”, shtohet teksti “**më së largu 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Amendamenti 22

Neni 36, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

3. Të dhënat lidhur me thirrjet e trafikut që janë mbledhur dhe janë ruajtur në përputhje me ligjin, sipas urdhrit gjyqësor, nga një operator rrjeti ose ofruesi i shërbimeve, duhet të vazhdojnë të ruhen nga operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve për një periudhë 9 (nëntë) mujore pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve duhet t'i vënë në dispozicion të dhënat e mbledhura dhe të ruajtura sipas paragrafit 3 të këtij neni për një periudhë prej 9 (nëntë) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kryetarja, pas diskutimeve dhe votimit të amendamenteve, nxori këtë

Rekomandim

Raporti me amendamentet e miratuara për Projektligjin për Telekomunikime, t'u dërgohen komisioneve kryesore dhe pastaj të dërgohen për miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,
znj. Teuta Sahatqija
